SHQIPËRIA NË SHIFRA

2014

Drejtor Botimi: **Dr. Gjergji FILIPI**

Përpunimi Statistikor: **INSTAT**

Copyright © INSTAT 2014

Ndalohet riprodhimi i këtij botimi apo transmetimi i tij në cilëndo formë, pa autorizimin paraprak me shkrim të mbajtësit të së drejtës së autorit.

Përpunimi në kompjuter: **Mariana Vllau**

INSTITUTI I STATISTIKAVE
Bul. "Zhan D'Ark", Nr.3, Tiranë / Albania
Tel: + 355 4 2222411 / 2233356
Fax: + 355 4 228300
e-mail: info@instat.gov.al
www.instat.gov.al

Përmbajtja


Demografia	5
Statistika Juridike	9
Parlamenti	11
Arsimimi dhe Njohuritë	13
Shëndetësia	17
Kultura	21
Papunësia	22
Punësimi	23
Çmimet dhe Konsumi	24
Tregtia me Pakicë	25
Tregtia e Jashtme	26
Transporti	27
Turizmi	28
Llogaritë Kombëtare	29
Banka	30
Regjistri i Ndërmarrjeve	33

Populllsia e Shqipërisë vazhdon të mbetet nën 3 milion që prej vitit 2001, megjithatë ritmi i rënies së saj ka qenë më i lartë përgjatë viteve 2001- 2010, ndërkohë që pas vitit 2010 ritmi i rënies së populllsisë është zvogëluar.


Kjo rënie e populllsisë i dedikohet më së shumti migracionit neto, i cili vazhdon të mbetet negativ (flukset dalëse tejkalojnë flukset hyrëse). Megjithatë migracioni neto, pikërisht diferenca ndërmjet imigrantëve dhe emigrantëve gjatë një viti të dhënë, ka pësuar një tkurrje pas vitit 2009, ardhur si pasojë e rritjes së numrit të të kthyerve, duke mundësuar në këtë mënyrë një rritje të migracionit neto.

Nga ana tjetër përsa i përket kontributit të komponentit të dytë, shtesës natyrore, diferencës ndërmjet lindjeve dhe vdekjeve, vihet re një ulje e numrit të lindjeve ndërkohë që numri i vdekjeve ka mbetur në nivele të njëjta, duke sjellë në këtë mënyrë një reduktim të saj gjatë viteve 2001-2014, por vazhdon të mbetet pozitive.

POPULLSIA DHE NORMA E RRITJES VJETORE, 2001-2014



LINDJE, VDEKJE DHE MIGRACIONI NETO, 2001-2014



A E DINI SE

Populllsia e Shqipërisë prej 2.9 million përbën rreth 0.4 për mijë të populllsisë së botës prej 7 bilion.

6 Demografia

Në vitin 2014, në totalin e popullsisë mesatare të Shqipërisë, të rinjtë (0-14 vjeç) zënë 18,9 %, ndërsa të moshuarit 65 vjeç e lart zënë 12,2 % të popullsisë gjithsej.

Po të hedhim një vështrim të strukturës së popullsisë ndër vite, duket qartë se pjesa që zënë të rinjtë në popullsinë gjithsej është zvogëluar dhe ajo që zënë të moshuarit është rritur. Shkaqet kryesore për këto fenomene lidhen me lindshmërinë e ulët dhe jetëgjatësinë e cila ka pësuar rritje. Në vitin 2001 të rinjtë zinin 29,3 % të popullsisë gjithsej, rreth 10 % më shumë krahasuar me pjesën që zënë ato në vitin 2014, e kundërta mund të thuhet për të moshuarit që zinin vetëm 7,6 % të popullsisë gjithsej në vitin 2001, rreth 5 % më pak krahasuar me vitin 2014.


Grafiku i mëposhtëm na paraqet raportet e varësisë moshore, tregues i cili analizon edhe më qartë strukturën e popullsisë. Raporti i varësisë së të moshuarve llogaritet si raport i popullsisë 65 vjeç e lartë ndaj popullsisë në moshë pune 15-64 vjeç. Për vitin 2014 ky raport në Shqipëri është 17,8 % kundrejt 12,0 % në vitin 2001. Ky raport shpreh një tendencë në rritje me kalimin e viteve, një peshë gjithnjë e në rritje ndaj popullsisë në moshë pune.

Raporti i varësisë së të rinjve llogaritet si raport i popullsisë 0-14 vjeç ndaj popullsisë në moshë pune 15-64 vjeç.


A E DINI SE

Popullsia e Shqipërisë po shkon drejt plakjes, nga 7,6 % të moshuar në 2001 sot kemi 12,2 % të moshuar.


PIRAMIDA E POPULLSISË, 2014



RAPORTET E VARËSISË MOSHORE, 2001-2014



LINDJET PËR 1.000 GRA



TREGUES KRYESOR PËR POPULLSINË E SHQIPËRISË

	Njësia	2010	2011	2012	2013	2014
Jetëgjatësia	vite					
Meshkuj		74,5	75,1	75,3	76,0	76,4
Femra		79,0	79,7	79,6	80,3	80,3
Indeksi sintetik i fekonditetit	për grua	**1,66**	**1,69**	**1,78**	**1,76**	**1,78**
Mosha mesatare në lindje	vite	**27,5**	**27,4**	**27,3**	**27,3**	**27,2**
Martesat	për 1.000 banorë	8,7	8,8	7,9	8,2	8,2
Divorcet		1,2	1,3	1,2	1,3	1,5

Raporti i varësisë së të rinjve për vitin 2014 është 27,4 % kundrejt 46,5 % në vitin 2001. Vihet re qartë një rënie e këtij raporti në vendin tonë, pothuajse në përgjysmimin e tij.

Në vitin 2001, indeksi sintetik i fekonditetit ka qenë 2,3 fëmijë për grua. Në vitet në vazhdim shënohet një rënie e tij. Në vitin 2008, u vu re një rënie e ISF nën nivelin e zëvendësimit, si tregoi anketa e DHS, përkatësisht 1,6 fëmijë për grua. Ky indeks vazhdon të mbetet nën 2,1 fëmijë për grua edhe gjatë viteve në vazhdim. Nëse do ti referoheshim normave specifike të lindshmërisë (lindjet për 1.000 gra), është grupmosha 25-29 në të cilën përqëndrohet numri më i lartë i lindjeve.

Shqiptarët sot jetojnë mesatarisht 1-2 vjet më shumë krahasuar me vitin 2010. Në vitin 2014 jetëgjatësia për femrat është 80,3 vjet dhe 76,4 vjet për meshkujt. Në vitin 2010 jetëgjatësia për femrat dhe meshkujt ishte përkatësisht 79,0 dhe 74,5 vjet.

INDEKSI SINTETIK I FEKONDITETIT
Numri mesatar i fëmijëve që një grua mund të lindë gjatë periudhës së saj riprodhuese 15-49 vjeç.

JETËGJATËSIA MESATARE NË LINDJE
Numri mesatar i viteve që një i lindur sot pritet të jetojë, duke marrë parasysh normat korrente të vdekshmërisë.

A E DINI SE
Gratë shqiptare jetojnë rreth 4 vjet më shumë se burrat.

8 Demografia


Krahasuar me vitin 2001 koeficenti bruto i martesave për vitin e fundit ka pësuar një rënie shumë të vogël (8,4 në 8,2). Vihet re rritje e tij në vitin 2003 (9,0) si dhe rënie drastike në vitin 2004 (6,9). Viti 2014 karakterizohet nga 8,2 martesa për 1.000 banorë. Ky koeficent ka pësuar luhatje gjatë periudhës pesëvjeçare 2010-2014.

E veçantë të përmendet është dhe mos-ndryshimi i moshës mesatare të martesës, ku meshkujt Shqiptarë në vitin 2001 martoheshin mesatarisht në moshën (29,3) ndërkohë sot (29,5) dhe femrat nga (24,1) në (24,0) gjatë vitit të fundit. Vlen gjithashtu të përmendet viti 2007 ku arrihet rekordi për moshën më të vogël mesatare të martesës, përkatesisht (27,7) për meshkujt dhe (22,4) për femrat. Grupmosha me numrin më të madh të martesave për femrat është (20-24) ndërsa për meshkujt (25-29).

Divorcet kanë pësuar një rritje të konsiderueshme nga viti 2001 (9,6 divorce për 100 martesa) në 2014 (17,8 divorce për 100 martesa). Viti 2014 shënon deri më tani dhe rekordin e divorceve ndër vite (4.240) si numër absolut divorcesh, ndërsa vlera më e lartë e divorceve shënohet në vitin 2006 me (19,1 divorce për 100 martesa).

A E DINI SE
Gushti është muaji më i preferuar nga Shqiptaret per t'u martuar.


KOEFICIENTI BRUTO I MARTESAVE, 2001-2014



MOSHA MESATARE E MARTESËS SIPAS GJINISË

Vitet	Meshkuj	Femra
2010	29,2	23,4
2011	29,3	23,6
2012	29,1	23,5
2013	29,3	23,7
2014	29,5	24,0

KOEFICIENTI I DIVORCEVE, 2001-2014



VEPRA PENALE TË EVIDENTUARA

	2010	2011	2012	2013	2014
Vepra të evidentuara	**14.368**	**15.713**	**18.639**	**19.930**	**26.910**
Kundër personit	**520**	**517**	**513**	**489**	**398**
Vrasjet	122	133	134	112	104
Vrasje e mbetur në tentativë	211	211	220	206	156
Krime seksuale	**79**	**44**	**44**	**87**	**97**
Krime në fushën e drogës	**526**	**647**	**957**	**1.105**	**1.243**
Prodhimi dhe shitja e narkotikëve	479	579	849	948	1.123
Krime Ekonomike - Financiare	**1.385**	**1.540**	**1.801**	**2.318**	**1.980**
Fallsifikim	494	704	683	533	553
Mashtrim	362	337	465	563	546
Krime të pronës	**4.879**	**5.612**	**6.188**	**6.053**	**8.365**
Vjedhje me dhunë	164	173	223	269	251
Vjedhje banese	957	979	1.238	1.277	1.657
Vjedhje lokale tregëtie	1.023	825	1.034	895	793
Krime në fushën e pastrimit të parasë	**228**	**86**	**116**	**125**	**326**
Pastrimi i produkteve	56	86	116	87	206
Krime të tjera	**6.751**	**7.267**	**9.020**	**9.753**	**14.501**
Dhuna në familje	**1.998**	**2.181**	**2.526**	**3.020**	**4.121**
Shkelje rregullave të qarkullimit rrugor	**961**	**1.933**	**2.049**	**2.987**	**4.315**

TË DËNUARIT SIPAS VEPRAVE PENALE, 2014

	2010	2011	2012	2013	2014
Gjithsej	8.510	9.754	9.562	8.577	13.618
Të dënuar të rritur	7.854	9.071	8.679	7.897	12.845
Të dënuar të mitur	656	683	883	680	773

Në vitin 2014 janë evidentuar 26.910 krime, rreth 35 % më shumë krime krahasuar me vitin 2013. Ashtu si totali i krimeve të evidentuara edhe për shumicën e grupveprave kryesore penale numri i krimeve ka ardhur në rritje për këtë 5 vjeçar. Në ndryshim nga krimet e tjera, Krimet kundër personit kanë ardhur në rënie.

Krahasuar me vitin 2010, në vitin 2014 veprat si Krimet e drogës dhe Krimet për pastrimin e produkteve kanë pësuar rritje të ndjeshme, përkatësisht me rreth dyfish më shumë krime të evidentuara për Krimet e drogës dhe rreth 4 herë më shumë krime për Pastrimin e produkteve.

Në vitin 2014 numërohen13.618 persona të dënuar, 94 % e të cilëve janë persona të rritur. Në krahasim me vitin 2010, në këtë vit janë 60 % më shumë persona të dënuar.

Krahasuar me vitin 2013, numri i të dënuarve në vitin 2014 ka pësuar rritje të ndjeshme me 58,8 % më shumë të dënuar.

Ndryshe nga vitet e tjera ku të dënuarit për krime tejkalonin të dënuarit për kundravajtje, në vitin 2014 kemi një shpërndarje pothuajse të barabartë midis të dënuarve për krime dhe kundravajtje penale.

A E DINI SE
40 % e vendimeve të gjykatës për të dënuarit kanë qenë " arrest me burg".

Të dhënat për dhunën në familje ndër vite na tregojnë për një rritje të numrit të raportimeve të dhunës në familje. Në vitin 2014 kemi 4.121 raportime të dhunës në familje, rreth 36 % më shumë krahasuar me vitin 2010.

Në figuren 1 është paraqitur përpjesa e secilës kategori (femra, meshkuj dhe të mitur) në totalin e personave të dhunuar. Për secilin vit përqindjen më të madhe të të dhunuarve e zënë femrat e dhunuara. Në vitin 2014 femrat zënë 75 % të totalit të personave të dhunuar. Krahasuar me vitin 2010, për këtë vit kemi 86 % më shumë femra të dhunuara. Ndërkohë të miturit zënë vetëm 5,2 % të totalit të dhunimeve.


Në vitin 2014 ndodhin 36 % më shumë raportime të dhunës në familje krahasuar me vitin 2010.

Në vitin 2014 numëroheshin 5.453 të burgosur, ndërsa në vitin 2010 numëroheshin 4.603, një rritje prej 18,5 % në numrin e të burgosurve.

Numri më i lartë i të burgosurve shënohet për veprat Vjedhje, Vrasje dhe për Krimet e drogës.

A E DINI SE
Përqindjen më të madhe të të burgosurve e zënë personat e dënuar për Vjedhje me 27,3 % .

PERSONAT E DHUNUAR NGA DHUNA NË FAMILJE, NË %



Shënim: Të miturit janë personat nën 18 vjeç si femra dhe meshkuj

TË BURGOSUR NDËR VITE

	2010	2011	2012	2013	2014
Gjithsej					
Të burgosur	4.603	4.590	4.550	4.914	5.453
Të burgosur të rritur	4.501	4.469	4.453	4.807	5.352
Të burgosur të mitur	102	121	97	107	101

TË BURGOSURIT SIPAS VEPRAVE PENALE , 2014

Lloji i veprës	**2014**
Vjedhje	1.491
Vrasje	1.342
Plagosje	186
Marrëdhënie seksuale me dhunë	112
Krime në fushën e drogës	1.142
Organizata kriminale	17
Mashtrim	74
Shfrytëzim prostitucioni	93
Të tjera	996
Gjithsej	5.453

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

PËRBËRJA E PARLAMENTIT SIPAS PARTIVE POLITIKE

Subjekti politik	Në (%)		
	2005-2009	2009-2013	2013-2017
Partia Socialiste (PS)	30	45	46
Partia Demokratike (PD)	40	49	36
Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI)	4	4	11
Partia BDNJ	1	1	1
Partia Republikane (PR)	8	1	2
Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	0	1	3
Partia Kristiandemokrate	0	0	1
Të tjera	17	0	0
Gjithsej	**100**	**100**	**100**

Burimi: Kuvendi

PËRBËRJA E QEVERISË SIPAS POZICIONIT DHE GJINISË, 2014

Pozicioni	Numër	
	Meshkuj	Femra
Kryeministër	1	0
Drejtor i kabinetit të Kryeministrit	0	1
Zv/Kryeministër	1	0
Drejtor i kabinetit të Zv/Kryeministrit	0	1
Sekretarë të Përgjithshëm	1	0
Ministra	12	7
Kryetar Parlamenti	1	0

Burimi: Kryeministria

Parlamenti përbëhet nga 140 anëtarë të zgjedhur një herë në katër vjet me sistemin propocional me zona zgjedhore shumemërore.

Në zgjedhjet e fundit të vitit 2013 qeveria u formua nga koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane" me 83 mandate, përkatësisht:

Partia Socialiste e Shqipërisë: 65 mandate

Partia Lëvizja Socialiste për Integrim:
16 mandate

Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut:
1 mandat

Partia Kristian Demokrate e Shqipërisë:
1 mandat

A E DINI SE
Zgjedhjet e vitit 2013 kanë sjellë përmirësime të rëndësishme duke e rritur në 21% numrin e vendeve të rezervuar për femrat në Parlament.

12 Parlamenti

Të dhënat në lidhje me përbërjen e Parlamentit Shqiptar vijnë nga legjislacionet përkatëse, 2001-2005, 2005-2009, 2009-2013, 2013-2017. Burimi i këtyre të dhënave është Kuvendi i Shqipërisë.

Gjatë periudhës 2001-2005, në Parlament pjesëmarrjen më të madhe e kanë pasur meshkujt konkretisht me 94 %.

Pas vitit 2009 vihet re një rritje e pjesëmarrjes së femrave në Parlamentin Shqiptar. Deri në fund të vitit 2014 shkalla e pjesëmarrjes së femrave në Parlament ka arritur 21 %.


Nga numri gjithsej i femrave deputete në parlament 55 % e tyre janë deputete të Partisë Socialiste, 31 % të Partisë Demokratike dhe 14 % të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim.

Qarqet në veri të vendit në total sjellin në Kuvend vetëm pesë përfaqësuese gra si deputete ndër të cilat janë 3 në qarkun e Shkodrës dhe 2 në qarkun e Lezhës.

Qarku i Kukësit, Gjirokastrës dhe Dibrës nuk kanë asnjë përfaqësuese femër në Kuvend.


A E DINI SE
Shkalla e pjesëmarrjes së femrave në Parlamentin Shqiptar nga viti 2001 deri në fund të vitit 2014 është rritur 3.5 herë.

PËRBËRJA E PARLAMENTIT NË %




*Nr i deputetëve deri në fund të vitit 2014
Burimi: Kuvendi


DEPUTETE FEMRA NË PARLAMENT SIPAS PARTIVE POLITIKE, 2014



SHKALLA DIPLOMIMIT NË ARSIMIN E MESËM



STUDENTË TË DIPLOMUAR SIPAS FUSHAVE TË STUDIMIT , VITI 2014 NË %



Arsimi vitin e fundit është karakterizuar nga reforma të thella. Këtu përfshihen strategjitë e reja të zhvillimit të arsimit universitar dhe parauniversitar. Cilësia e mësimdhënies, dixhitalizimi, përmirësimi i kurikulave, rritja e arsimit profesional, janë disa nga sfidat në të cilat po kalon arsimi parauniversitar. Ndërsa kërkesa për universitete sa më cilësore, të orientuara drejt kërkimit shkencor, rritja e autonomisë së tyre, përbëjnë drejtimet kryesore në të cilat po synon të zhvillohet arsimi i lartë. Institucionet e arsimit të lartë privat ju nënshtruan procesit të kontrollit të cilësisë së shërbimit të ofruar.

Niveli arsimor i popullsisë shqiptare është rritur gradualisht. Rritja e pjesëmarrjes në arsim vërehet në të gjitha nivelet.
Përsa i përket arsimit të mesëm, përparësi e madhe po i jepet dy vitet e fundit atij profesional.

Veçanërisht i lartë është interesi për ndjekjen e arsimit të lartë. Përfunduan studimet e ciklit të parë 60 % e të diplomuarve të vitit 2014 dhe 40 % përfunduan studimet e ciklit të dytë master ose ekuivalent.

A E DINI SE
Numri i të diplomuarve në arsimin e lartë në vitin 2014 është rritur gati dy herë krahasuar me vitin 2009.

14 Arsimi dhe Njohuritë

Popullsia me arsim të mesëm ka njohur rritje të theksuar në 15 vitet e fundit.
Të diplomuarit e arsimit të mesëm të vitit 2014 krahasuar me popullsinë e moshës përkatëse, janë 61,7 % nga 32 % që ishin në vitin 2001.

Ndër të diplomuarit mbizotërojnë ato me arsim të mesëm të përgjithshëm, megjithëse në vitet e fundit i është kushtuar rëndësi e veçantë arsimit profesional.

Interesant është fakti që 4 vitet e fundit ka filluar të kemi persona që arsimohen në arsimin pas të mesëm përpara së të vazhdojnë studimet universitare ose të specializohen në profesione të caktuara.

Pavarësisht se vlera absolute e numrit të nxënësve në arsimin 9 vjeçar vjen në ulje vit pas viti, pjesëmarrja e nxënësve në këtë nivel arsimi është e lartë.

Përfunduan arsimin 9 vjeçar në vitin 2014, 53,4 % nxënës në qytet dhe 46.6 % në fshat. Përqindjen më të lartë të tyre prej 51,8 % e mbajnë djemtë përkundrejt 48,2 % vajza, raport i cili ndryshon vit pas viti në favor të djemve.

Krahasuar me popullsinë përkatëse vërehet një rritje në përqindje e të diplomuarve të arsimit 9 vjeçar nga viti në vit.

A E DINI SE
Pjesëmarrja e lartë e femrave në arsimin e lartë ka qenë tendencë e cila vazhdon edhe vitin e fundit; të diplomuar femra janë 65 %.


NUMRI I TË DIPLOMUARVE NË ARSIM

Arsimi	2010-11	2011-12	2012-13	2013-14
9 vjeçar	51.186	50.380	47.819	44.139
Të mesëm	40.354	40.927	45.899	35.254
Profesional	4.801	2.844	4.322	3.136
Pas të mesme jo të lartë	232	242	145	164
Të diplomuar gjithsej	22.814	29.130	30.365	29.137
Master ose ekuivalent	8.804	8.240	10.014	11.668
Bachelor	14.010	20.871	20.351	17.469

RAPORTI NXËNËS PËR MËSUES


Arsimi	2011-12	2012-13	2013-14	2014-15
Në arsimin publik				
9 vjeçar cikli i ulët	**19,9**	**19,4**	**19,1**	**18,9**
Qytet	26,0	25,6	25,4	25,0
Fshat	16,1	15,5	15,2	14,9
9 vjeçar cikli i lartë	**13,6**	**13,2**	**12,6**	**12,2**
Qytet	16,1	15,8	15,2	14,9
Fshat	11,8	11,4	10,7	10,3
I mesëm	**17,6**	**17,7**	**17,0**	**16,2**
Qytet	17,8	17,9	17,2	16,9
Fshat	17,0	17,4	16,4	14,5
Në arsimin privat				
9 vjeçar cikli i ulët	**14,6**	**15,4**	**16,0**	**15,3**
Qytet	14,7	14,8	15,9	15,1
Fshat	14,3	22,4	17,9	18,1
9 vjeçar cikli i lartë	**8,3**	**8,7**	**8,8**	**8,3**
Qytet	8,3	8,6	8,8	8,2
Fshat	7,7	10,3	8,1	9,6
I mesëm	**8,9**	**8,9**	**9,7**	**9,1**
Qytet	8,9	8,8	9,3	9,9
Fshat	8,2	11,0	n.a.	3,4

VENDI KU PERDORET INTERNETI



Burimi: Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës 2012

ARSYET E PËRDORIMIT TË INTERNETIT



Zotërimi i kompjuterave në familje ka ardhur në rritje. Në vitin 2012, ka katër herë më shumë familje që kanë të paktën një kompjuter në krahasim me vitin 2005.
Në vitin 2012, një e katërta e individëve 10 vjeç e lart kanë përdorur kompjuter në tre muajt e fundit dhe 22,5 % kanë përdorur internetin.

Përdoruesit e internetit më së shumti e përdorin internetin në shtëpi ose në pikat e aksesit publik dhe disi më pak në punë apo në vendin ku mësojnë.

Një përdorim të gjerë ka dhe përdorimi i internetit nëpërmjet pajisjeve të lëvizshme apo telefonit. Ofertat e grupuara së bashku me format e tjera të komunikimit kanë sjellë mjaft lehtësi në përdorimin e internetit nëpërmjet telefonit.

Komunikimi nëpërmjet e-mail dhe nëpërmjet rrjeteve sociale janë dy arsyet kryesore pse Shqipëtarët e moshës mbi 10 vjeç e përdorin internetin. Në vitin 2012 mbi 60 % e tyre e përdorin internetin për arsyet e sipërpërmendura. Nga ana tjetër interneti përdoret për shërbime bankare dhe trajnime online respektivisht në 3 % dhe 2 % të rasteve. Këto janë dhe dy arsyet për të cilat interneti përdoret më rrallë.

A E DINI SE
Në vitin 2012, 16,8 % e përdoruesve të internetit nuk kishin një adresë e-maili.

16 Arsimi dhe Njohuritë

Sipas të dhënave të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare vihet re një tendencë në rënie e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse dhe i numrit të përdoruesve aktivë të telefonisë celulare për periudhën 2012 - 2014. Për sa i përket telefonisë celulare, vihet re një rritje e shpejtë e numrit të minutave të thirrjeve telefonike të gjeneruara nga përdoruesit.

E njëjta tendecë vërehet edhe për numrin e mesazheve SMS të gjeneruara nga këta përdorues. Gjatë periudhës 2012 – 2014 ka pasur rritje edhe në numrin e lidhjeve broadband nga rrjete fikse të internetit. Në të njëtën periudhë numri i përdoruesve të internetit nga rrjete broadband 3G nga aparate celulare është rritur më shumë se 2 herë.


PËRDORIMI I TELEFONISË DHE RRJETEVE BROADBAND TË INTERNETIT

	Njësia	2012	2013	2014
Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse	për 100 pers.	11	10	9
Numri i përdoruesve aktivë të telefonisë celulare		122	127	116
Numri i pajtimtarëve që kanë përdorur broadband 3G nga aparate celulare		21	39	43
Numri i lidhjeve broadband nga rrjete fikse		6	6	7
Thirrje telefonike dalëse të gjeneruara nga përdoruesit e telefonisë celulare	milion minuta	6.053	6.769	7.301
Numri i SMS të gjeneruara	milion mesazhe	1.383	1.689	1.826

Burimi: Autoriteti i komunikimeve elektronike dhe postare, Raporti vjetor 2014


A E DINI SE
Sipas AMNJ 2012, 20,4 % e familjeve zotërojnë kompjuter dhe 92,4 % zotërojnë telefon celular.

VDEKSHMËRIA FOSHNJORE NË SHQIPËRI PËR 1,000 LINDJE TË GJALLA



Burimi: INSTAT

VDEKSHMËRIA AMTARE NË SHQIPËRI PËR 100,000 LINDJE TË GJALLA



Burimi: Ministria e Shëndetësisë

Shumë ndryshime kanë ndodhur përsa i përket shëndetit gjatë dy dekadave në Shqipëri, kjo në veçanti në lidhje me shëndetin e nënës dhe fëmijës. Në vitin 2013 vdekshmëria foshnjore është ulur ndjeshëm, dhe shihet një tendencë në rënie. Ky tregues është 7,9 për njëmijë lindje të gjalla.
Gjithashtu, ka evidencë të një ulje të qëndrueshme të nivelit të vdekshmërisë amtare, gjatë dy dekadave të fundit, respektivisht 37,7 në vitin 1990, në 11,2 (për 100.000 lindje të gjalla) vitin 2013. Pothuajse të gjitha lindjet në Shqipëri asistohen nga personeli shëndetësor i kualifikuar dhe 99 % e tyre në vitin 2013 ishin në maternitete dhe shtëpi lindjeje.

Nga këto vizita mosha mbi 60 vjeç zinte 1/3 e vizitave në qëndra shëndetësore dhe ambulanca, ndërsa shërbimi i specializuar sipas specialiteteve në parësor zë 29 % të vizitave totale.

Në shërbimin publik parësor kontakti për person me mjekun e familjes dhe specialistin është 2,2 kontakt për person. (Pra çdo person merr kujdes shëndetësor parësor mesatarisht 2 kontakte në vit.)

A E DINI SE
Në vitin 2013 numri i vizitave të kryera në shërbimin parësor tek mjeku i familjes, mjeku specialist, etj ishte 6.2 milion.

18 Shëndetësia

Mbulimi i përgjithshëm i vaksinimit të fëmijëve vazhdon të jetë mjaft i lartë (99 %).

Në lidhje për infrastrukturën spitalore shëndetësore publike, numri i shtretërve spitalor tregon disponueshmërinë e shërbimeve spitalore.
Numri i spitaleve dhe i shtretërve spitalorë është ulur gjatë viteve të fundit në Shqipëri, por niveli i shfytëzimit të shtratit është ende i ulët, kjo për sektorin publik në vlerat 48 %, për shkak se sektori privat sapo ka lulëzuar në Shqipëri.

Shpenzimet totale për shëndetësinë llogariten si shuma e shpenzimeve publike dhe private të bëra për shëndetësinë. Ato mbulojnë shërbimet shëndetësore (parandaluese dhe kuruese), aktivitetet e planifikimit familjar, ndihmat emergjente për shëndetin, etj. Të dy sektorët kanë një peshë jo të vogël ndaj totalit të shpenzimeve për shëndetësinë, por aktualisht shpenzimet publike zënë 3 % të PBB.

Vetëvlerësimi pozitiv i gjendjes shëndetësore është rritur. Në vitin 2012 më shumë se 85 % e individëve ndjehen shumë mirë ose mirë, krahasuar me vitin 2002 kur kjo përqindje ishte 75,3 %.

A E DINI SE
Numri i spitaleve në vitin 2013 ishte 1.5 spitale për 100.000 banorë.

INSTITUCIONE SHËNDETËSORE

Institucione Shëndetësore Spitale	2009	2010	2011	2012	2013
Numri i spitaleve	**44**	**44**	**44**	**44**	**44**
Numri i shtretërve spitalor	8.805	8.707	8.711	8.723	8.283
Të shtruar në spitale	**265.200**	**258.407**	**240.562**	**247.391**	**260.727**
Numri i shtretërve për 100 mijë banorë	300	300	300	300	290
Ditë qëndrimi mesatar	5,7	5,8	5,7	6,1	5,5
Ditë-shtretër të realizuar (në mijë)	1.509	1.472	1.404	1.509	1.442
Shfrytëzimi i shtratit (në ditë)	172	169	161	173	174
Numri i institucioneve gjithsej:	**2.434**	**2.448**	**2.472**	**2.460**	**2.453**
– Qëndrat shëndetësore	624	475	456	421	409
– Ambulanca	1.812	1.927	1.970	1.946	1.998
– Poliklinika	46	46	46	46	46
Vizita gjithsej (në mijë)	**5.749**	**6.551**	**6.925**	**6.983**	**6.252**


Burimi: Ministria e Shëndetësisë

VETËVLERËSIMI I GJËNDJES SHËNDETËSORE

	2002	2005	2008	2012
Vlerësimi				
Shumë mirë	32,6	43,1	38,9	52,7
Mirë	42,7	36,3	41,8	33,6
Mesatare	15,6	12,2	11,7	10,5
Keq	7,6	7,3	6,3	2,8
Shumë keq	1,5	1,1	1,3	0,4
Total	100	100	100	100

Burimi: Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës 2002, 2005, 2008, 2012

PËRQINDJA E STUDENTËVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR SIPAS UNIVERSITETEVE PUBLIKE, VITI AKADEMIK 2014-2015



Për herë të parë INSTAT mblodhi nga Universitet publike numrin e studentëve me aftësi të kufizuara që ndjekin studimet e larta Bachelor dhe Master.

Sipas të dhënave janë afërisht 400 studentë të regjistruar me aftësi të kufizuar në këto universitete.

Shpërndarja e tyre sipas gjinisë është 57 % meshkuj dhe 43 % femra.

Universiteti i Elbasanit zë pjesën më të madhe të studentëve me aftësi të kufizuara, i ndjekur nga ai i Tiranës dhe i Vlorës. Ndërkohë Universiteti i Mjekësisë dhe i Arteve kanë pjesën më të vogël të këtyre studentëve.

A E DINI SE

Për vitin akademik 2014-2015 janë afërsisht 400 studentë të regjistruar me aftësi të kufizuar në Universitetet Shqiptare Publike, ndër të cilët 1/3 e tyre studion në Universitetin e Elbasanit.

20 Shëndetësia

Një aspekt i rëndësishëm që ndikon tek shëndeti është pirja e duhanit dhe e alkoolit. Në vitin 2012, 9,4 % e individëve të moshës 10 vjeç e lart pijnë aktualisht duhan dhe 24,3 % pijnë alkool. Kjo përqindje është ulur ndër vite sidomos krahasuar me vitin 2005.


Shpërndarja e duhanpirësve sipas grupmoshave për vitin 2012, tregon një përqindje më të lartë të duhanpirësve në grupmoshat 25-44 vjeç krahasuar me vitet e tjera ku përqëndrimi i tyre shihej në moshat më të larta.

Kontaktet me ofruesit e shërbimit shëndetësor janë ulur për të gjitha format: vizitat në ambulancë, tek doktori privat, shtrimet në spital apo kujdesi shëndetësor i marrë nga infermierë, ndihmësmjekë dhe mami. Po ashtu vizitat tek dentisti janë ulur ndjeshëm, nga 20,3 % në vitin 2002 në 9,8 % në vitin 2012.

Në vitin 2012, rreth 60 % e popullsisë është e pajisur me librezë shëndetësore. Përqindja e individëve që janë të pajisur me librezë shëndetësore është rritur rreth 1,6 herë në vitin 2012 në krahasim me vitin 2002.

A E DINI SE
Duhanpirësit pijnë mesatarisht rreth 20 cigare në ditë.

DUHANPIRËS SIPAS GRUPMOSHAVE



Burimi: Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës, 2005, 2008, 2012

KUJDESI SHËNDETËSOR

	2002	2005	2008	2012
Në 4 javët e fundit				
Vizituar në ambulancë	14,4	10,5	8,7	6,4
Vizituar në doktor privat	1,7	1,5	0,9	0,8
Vizituar në infermiere, ndihmësmjek, mami	3,1	1,4	0,8	0,4
Në vitin e fundit				
Shtrime në spital	4,3	4	2,8	1,4
Vizita tek dentisti	20,3	20,7	12,8	9,8

Burimi: Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës 2002, 2005, 2008, 2012

INSTITUCIONE TË KULTURËS DHE ARTIT 2013-2014

	2013	2014
Biblioteka Kombëtare		
Tituj libri të hyrë gjatë vitit	4.826	4.961
Libra të tërhequr nga lexues gjatë vitit	187.248	194.937
Lexues të regjistruar në bibliotekë gjithsej	5.588	6.316
Frekuentues në sallat e leximit	173.039	195.138
Aktivitete për librin	129	266
Teatri i Operas dhe i Baletit		
Kapaciteti i sallës	800	800
Numri i shfaqjeve	90	190
Spektatorë	14.170	37.591
Trupa profesioniste efektive	_	181
Teatri Kombëtar		
Kapaciteti i sallës	540	540
Numri i shfaqjeve	41	124
Spektatorë	9.441	9.770
Trupa profesioniste efektive	31	32
Teatri Kombëtar i Komedisë		
Kapaciteti i sallës	200	244
Numri i shfaqjeve	51	104
Spektatorë	8.600	14.736
Trupa profesioniste efektive	10	10
Teatri i Kukullave		
Kapaciteti i sallës	162	162
Numri i shfaqjeve	151	159
Spektatorë	12.254	18.043
Trupa profesioniste efektive	11	11
Arkivi Qendror i Filmit		
Programe (shfaqje) filmi gjithsej	97	127
Spektator ne filmat e shfaqur	900	1.500
Galeria Kombëtare e Arteve		
Ekspozita të çelura	13	20
Veprat e ekspozuara në linjën e përherëshme	192	192
Vizitorë	22.350	24.715
Botime	_	2
Instituti i Monumenteve të Kulturës		
Monumente të Kulturës	1.718	1.790
Vizitorë ne Monumentet e Kulturës	55.723	110.535
Muzeume		
Muzeume	8	9
Vizitorë ne Muzeumet	147.256	130.698

Kultura përfaqësohet nga Biblioteka Kombëtare, Teatrot, Arkivin Qëndror të Filmit, Galerinë Kombëtare të Arteve, Monumentet Kulturore dhe Muzeumet. Duke krahasuar vitin 2013 dhe 2014, shohim një rritje të numrit të aktiviteteve po ashtu rritje edhe të frekuentimit të tyre.

Krahasuar me vitin 2013, në vitin 2014 kemi një rritje prej 4,1 % libra të tërhequr nga lexues dhe një rritje 12,7 % frekuentues në sallat e leximit.Frekuentuesit me të shumtë jane të rinj të grupmoshës 16-21 vjeç në të dyja vitet, përkatësisht me 100.363 frekuentues në 2013 dhe 113.180 në vitin 2014.

Teatrot mbeten të frekuentuara. Kjo duket nga rritja e numrit të shfaqjeve dhe gjithashtu nga rritja e numrit të spektatorëve në këto dy vite.

Një e veçantë tjetër në Shqipëri është rritja e numrit të vizitorëve në Monumentet Kulturore. Kjo shifër pothuajse është dyfishuar nga 55.723 në 110.535. Frekuentimi më i madh është nga shtetasit e huaj por pa lënë pas edhe vendasit. Monumentet më të vizituara janë në qytetet: Gjirokastër, Berat dhe Shkodër. Nga ana tjetër, në Muzeume numri i vizitorëve është ulur me 12,6 %.

A E DINI SE
Për vitin 2014, filmi më i parë në kinematë kryesore ka qenë Ujku i Wall Street .

22 Papunësia

Gjatë 20 viteve të fundit, shkalla e papunësisë ka qenë përgjithësisht më e lartë për femrat se sa për meshkujt. Ky model duket të jetë i ndryshëm për vitin 2007 dhe për tre vitet e fundit kur shkalla e papunësisë së meshkujve ka qenë më e lartë se sa e femrave. Për më tepër, diferenca në shkallët e papunësisë së meshkujve dhe femrave ka ardhur në rritje në tre vitet e fundit në favor të meshkujve. Tregu i Punës karakterizohet nga një shkallë e lartë e papunësisë për të rinjtë. Në vitin 2014, shkalla e papunësisë për të rinjtë e moshës 15-29 vjeç ishte 32,5 %, ndërkohë që shkalla e papunësisë për popullsinë 30-64 vjeç ishte 13,3 %.


Një tregues tjetër që pasqyron situatën e të rinjve, është përqindja e të rinjve 15-24 vjeç që nuk ishin të punësuar dhe nuk ndiqnin shkollën apo ndonjë formim profesional. Në vitin 2014 ky tregues ishte 30,9 %.

SHKALLA E PAPUNËSISË
Të papunët si përqindje ndaj totalit të forcave të punës.

PAPUNËSIA
Personat 16 vjeç e lart pa një punë, duke kërkuar punë/të registruar në Zyrat e Punës dhe të disponueshëm për të filluar një punë ("të papunë të regjistruar") deri në vitin 2006, dhe personat 15 vjeç e lart pa një punë, në kërkim të një pune dhe të disponueshëm për të filluar një punë (të papunë në përputhje me definicionin e ILO-s) që prej vitit 2007.

A E DINI SE
Tregu i Punës karakterizohet nga një shkallë e lartë papunësie për të rinjtë.

SHKALLA E PAPUNËSISË




PAPUNËSIA

	Njësia	1995	2000	2005	2010	2014
Të papunë	1 000	**171**	**215**	**153**	**191**	**220**
Meshkuj	-	91	113	74	97	139
Femra	-	80	102	79	94	81
Shkalla e papunësisë	përqindje	**12,9**	**16,8**	**14,1**	**14,0**	**17,5**

Burimi: INSTAT; Të dhëna administrative deri në 2006, Anketa e Forcave të Punës që prej 2007

SHKALLA E PUNËSIMIT



STATUSI NË LIDHJE ME PUNËSIMIN E POPULLSISË

	Njësia	1995	2000	2005	2010	2014
Popullsia gjithsej	1 000	**3,225**	**3,061**	**3,011**	**2,913**	**2,894**
Forcat e punës gjithsej	-	**1,309**	**1,283**	**1,085**	**1,358**	**1,257**
Meshkuj	-	775	754	655	767	725
Femra	-	534	529	430	591	532
Të punësuar gjithsej	-	**1,138**	**1,068**	**932**	**1,167**	**1,037**
Meshkuj	-	684	641	576	670	586
Femra	-	454	427	356	497	451
Shkalla e punësimit*	përqindje	**62,5**	**60,5**	**45,6**	**53,5**	**50,5**
Meshkuj	-	74,7	71,2	51,4	63,1	58,0
Femra	-	50,2	49,3	38,6	44,5	43,4

Burimi: INSTAT; Të dhëna administrative deri në 2006, Anketa e Forcave të Punës që prej 2007
*) llogaritur mbi popullsinë meshkuj 15-64 vjeç dhe femra 15-59 vjeç deri në vitin 2006, dhe mbi popullsinë 15-64 vjeç që prej 2007

Një pjesë e madhe e meshkujve janë aktivë në tregun e punës në Shqipëri dhe ka një hendek relativisht të konsiderueshëm dhe të vazhdueshëm në kohë në shkallën e punësimit, e cila rezulton më e lartë te meshkujt se sa te femrat. Diferenca ndërmjet shkallës së punësimit të meshkujve dhe femrave në vitin 2014 ishte 14,6 pikë përqindje.

FORCAT E PUNËS
Shuma e personave të punësuar dhe të papunë në moshë 15 vjeç e lart.

Nga ana tjetër, një pjesë e konsiderueshme e femrave në moshë pune janë inaktive (48,7 % në vitin 2014) ose punojnë si punëtore pa pagesë në biznesin e familjes kryesisht në fermat bujqësore. Ndër punëtorët pa pagesë të familjes, femrat kanë pothuajse 1,7 herë më shumë gjasa sesa meshkujt, për të qenë punëtore pa pagesë në biznesin e familjes. Në vitin 2014, 42 % e femrave të punësuara dhe 25 % e meshkujve të punësuar ishin punëtorë pa pagesë të familjes.

A E DINI SE
Në vitin 2014, punësimi në Shqipëri dominohet nga sektori bujqësor dhe nga sektori i shërbimeve me peshë përkatësisht 42,7 % dhe 39,4 % ndaj totalit.

24 Çmimet dhe Konsumi

Peshat e shportës së Indeksit të Çmimeve të Konsumit, ndryshuar në dhjetor të vitit 2007, janë bazuar në të dhënat e Anketës së Buxhetit të Familjeve. Por si pasojë e ndryshimeve metodologjike, peshat e grupeve në shportën e përdorur për llogaritjen e IÇK ndryshojnë nga struktura e konsumit që paraqesin rezultatet e anketës. Shporta përmban edhe një pjesë produktesh të cilat nuk përfshihen në llogaritjen e shpenzimeve të familjes për konsum si qeraja e imputuar, pajisjet afat-gjatë dhe investimet kapitale.

Ndryshimi mesatar vjetor i indeksit të Çmimeve të Konsumit në vitin 2014 është 1,6 %.

Rritja më e madhe e çmimeve prej 7,0 % vërehet në grupin "Pije alkolike dhe duhan" duke kontribuar me 0.25 pikë përqindje në ndryshimin mesatar vjetor. Ulja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin "Shëndeti" me 4,5 % duke kontribuar me -0.15 pikë përqindje në ndryshimin mesatar vjetor.

KONSUMI


Statistikat e konsumit janë shumë të rëndësishme për të analizuar zhvillimet socio-ekonomike në vend. Shpenzimet e buxhetit të familjes japin informacion jo vetëm mbi nivelin dhe strukturën e konsumit të familjeve shqiptare, por shërbejnë edhe për të përditësuar IÇK.

Statistikat e Çmimeve të Konsumit luajnë rol kyç në matjen e inflacionit nga konsumatorët.


A E DINI SE

Çmimet e konsumit filluan të stabilizohen që nga viti 1999, vit ku ndryshimi vjetor në fund të vitit ishte -1,0.


PESHAT E IÇK DHE STRUKTURA E ABF SIPAS 12 GRUPEVE KRYESORE TË KONSUMIT



NDRYSHIMI MESATAR VJETOR I ICK



INDEKSI I TREGTISË ME PAKICË PËR PRODUKTET USHQIMORE DHE JO USHQIMORE NË NJËSI TREGTARE TË SPECIALIZUARA DHE JO TË SPECIALIZUARA



INDEKSET E VOLUMIT NË TREGTINË ME PAKICË DHE TREGTINË ME PAKICË TË HIDROKARBUREVE

2010=100

NVE Rev 2	Aktiviteti ekonomik	Vitet			
		2011	2012	2013	2014
47	**Tregti me Pakicë**	**106,5**	**111,6**	**118,6**	**124,6**
47pa473	**Tregti me Pakicë (pa përfshirë Tregtinë me pakicë të hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara)**	**96,9**	**95,0**	**103,0**	**108,3**
4711	Artikuj të përzier kryesisht ushqime, pije, duhan në njësi tregtare jo të specializuara	98,9	80,5	86,0	100,3
4719	Artikuj të përzier kryesisht jo ushqimore në njësi tregtare jo të specializuara	114,0	92,2	98,6	85,0
472	Ushqime pije e duhan në njësi tregtare të specializuara.	98,1	103,5	115,6	102,4
474	Pajisje kompjuterike, informatike dhe te konukacionit	72,6	79,1	129,7	132,9
475	Paisje të ndryshme elektro-shtëpiake, mobiljet dhe pajisje të tjera shtëpiake	104,6	113,2	130,9	133,1
476	Libra, gazeta, artikuj shkollor, produkte të argëtimt, pajisje sportive, lodrat, lojrat dhe të tjera produkte industriale në njësi tregtare të specializuara	73,9	80,5	96,1	105,2
4771-4772	Veshje, këpucë dhe artikuj prej lëkure	96,9	91,7	103,8	124,3
4773-4775	Produkte farmaceutike, mjeksore dhe ortopedike, kozmetike, parfume dhe të tjera të higjenës personale	109,2	127,0	126,8	141,7
4776-4778	Atikuj të tjerë industrial në njësi tregtare të specializuara të pa klasifikuara në grupet e sipër përmendura	72,6	79,0	40,8	51,3
473	**Tregti me pakicë e hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara**	**134,6**	**157,4**	**162,5**	**170,6**

Indeksi në volum në Tregtinë me Pakicë gjatë harkut kohor 2011-2014 është rritur mesatarisht 5.7 % në vit. Nëngrupet kryesore të saj kanë patur një ritëm rritjeje përkatësisht 14,9 % në vit në nëngrupin "Tregti me Pakicë e hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara dhe jo të specializuara", 2,9 % në vit "Artikuj jo ushqimorë në njësi tregtare të specializuara dhe jo të specializuara" dhe 0,7 % në vit "Produktet ushqimore në njësi tregtare të specializuara dhe jo të specializuara".

Në harkun kohor 2005-2010, vihet re një ritëm rritje mesatar më i madh i nëngrupit "Produkte ushqimore në njësi tregtare të specializuara dhe jo të specializuara", dhe nga viti 2011-2014 kjo situatë përmbyset dhe ritmin mesatar të rrities më të madhe e zëvendëson nëngrupi "Artikuj jo ushqimorë në njësi tregtare të specializuara dhe jo të specializuara".

Indeksi në volum i Tregtisë me Pakicë mat ecurinë mujore të shitjeve, të vlerësuara me çmimet aktuale, në njësitë ekonomike të cilat kryejnë veprimtari të tregëtimit me pakicë të produkteve ushqimore, artikujve jo ushqimorë dhe hidrokarbureve. Indekset e nëngrupeve janë deflatuar me çmimet e konsumit të nëngrupeve përkatëse.

A E DINI SE


Në vitin 2014 në Tregtinë me Pakicë vazhdon të kontribuojë kryesisht nëngrupi "Tregti me pakicë e hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara dhe jo të specializuara".

Në këto 20 vite volumi tregtar i mallrave është rritur mesatarisht rreth 13,7 % në vit, duke patur një rritje mesatare vjetore për eksportet rreth 17,5 % dhe 12,7 % për importet.
Grupet më të rëndësishme të mallrave që Shqipëria eksporton janë ato të tekstileve dhe këpucëve; produkteve minerale dhe metalet bazë.
Grupet më të rëndësishme të mallrave që Shqipëria importon janë ato të makineri e pajisjeve mekanike dhe elektrike; ushqime, pije, duhan dhe produktet minerale.
Dy nga partnerët kryesorë si për eksportet, ashtu edhe për importet për vitin 2014, janë Italia dhe Turqia, duke zënë rreth 55,9 % të eksporteve shqiptare dhe 36,9 % të importeve shqiptare.

Bilanci tregtar është diferenca ndërmjet vlerës së mallrave që një vend eksporton dhe vlerës së mallrave që një vend importon.
Nëse eksportet kalojnë importet atëherë vendi ka një suficit tregtar dhe bilanci tregtar është pozitiv. Nëse importet kalojnë eksportet vendi ka defiçit tregtar dhe bilanci tregtar është negativ. Megjithatë fjalët "pozitive" dhe "negative" kanë vetëm një kuptim numerik dhe jo domosdoshmërisht reflektojnë nëse ekonomia e një vendi është duke u zhvilluar pozitivisht ose jo.

A E DINI SE
Në vitin 2014 eksportet e grupeve "Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike" dhe "Tekstile dhe këpucë" zënë ekzaktësisht të njëjtën peshë, 33,6 % secili, të eksporteve shqiptar.

TREGTIA E JASHTME DHE BILANCI TREGTAR I MALLRAVE



** 2012 Gjysëm-finale*
***2013 Paraprake*
^ Seria 1996-2007 nuk reflekton rishikimet e reja

TREGTIA E JASHTME E MALLRAVE


milion lekë

	1995	2000	2005	2010	2014
Eksporte (FOB)	18.710	37.037	65.818	161.548	255.759
Importe (CIF)	66.147	157.109	262.191	477.768	552.264
Bilanci tregtar (Eksporte-importe)	-47.437	-120.072	-196.373	-316.220	-296.505
Volumi tregtar (Eksporte+Importe)	84.857	194.146	328.009	639.315	808.023
Përqindja e mbulimit (%)	28,3	23,6	25,1	33,8	46,3

PESË PARTNERËT KRYESORË TREGTARË, 2014

Eksporte			Importe		
	milion lekë	% ndaj gjithsej		milion lekë	% ndaj gjithsej
Itali	133.046	52,0	Itali	164.409	29,8
Kosovë	18.774	7,3	Greqi	52.058	9,4
Spanjë	16.684	6,5	Kinë	40.331	7,3
Maltë	15.906	6,2	Turqi	39.011	7,1
Turqi	10.094	3,9	Gjermani	32.964	6,0

NUMRI I PASAGJERËVE QË UDHËTOJNË ME MJETE TË TRANSPORTIT DETAR, AJROR DHE HEKURUDHOR



LËVIZJA E MALLRAVE SIPAS MËNYRËS SË TRANSPORTIT

	Eksporte		Importe	
	milion lekë	% ndaj gjithsej	milion lekë	% ndaj gjithsej
Gjithsej	**255.759**	**100,0**	**552.264**	**100,0**
Transporti detar	188.787	73,8	293.366	53,1
Transporti rrugor	64.564	25,2	203.824	36,9
Transporti ajror	1.633	0,6	19.238	3,5
Mënyra të tjera transporti	775	0,3	35.836	6,5

Në periudhën dhjetë vjeçare, 2005-2014, numri mesatar i pasagjerëve që udhëtojnë me linjat detare është rriur me 1,4 %, në vit, i pasagjerëve që udhëtojnë me linjat ajrore me 10,1 %, ndërsa atyre që udhëtojnë me linjat hekurudhore është ulur mesatarisht me 18 % gjatë të njëjtës periudhë.

Numri i pasagjerëve që udhëtojnë me ajër zë mesatarisht 54,0 % të numrit të pasagjerëve gjithsej që udhëtojnë me (det, ajër dhe hekurudhë), i ndjekur nga numri i pasagjerëve që udhëtojnë me det me 34,5 % dhe atyre me hekurudhë 11,5 %, në harkun kohor 2005-2014.

Në vitin 2014 mallrat e transportuara nëpërmjet detit zënë rreth 73,8 % të eksporteve shqiptare dhe rreth 53,1 % të importeve shqiptare.

TRANSPORT
Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave, duke përdorur mjete të ndryshme transporti. Transporti mund të kryhet me mjete të transportit tokësor, ajror dhe detar.

A E DINI SE
Rreth 60 % e volumit tregtar të mallrave në vitin 2014 janë transportuar me det, ndërsa, numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjat hekurudhure, në vështrim kohor, nga 34,5 % zë 11.6 % në 2014.


Hyrjet e shtetasve të huaj në pikat kufitare në periudhën kohore 2005-2014 janë rritur mesatarisht 19,9 % në vit, ndërkaq daljet e shtetasve shqiptarë janë rritur mesatarisht 6,9 %.
Gjatë harkut kohor 2010-2014 hyrjet e shtetasve të huaj nga rajoni i Evropës zënë pjesën më të madhe të hyrjeve gjithsej, mesatarisht 92,3 %. Evropa Jugore zë përqindjen më të lartë të hyrjeve të shtetasve të huaj me 84,3 % të hyrjeve gjithsej nga Evropa. Hyrjet nga Kosova zënë mesatarisht 48,6 % të hyrjeve të Evropës Jugore të ndjekura nga hyrjet që vijnë nga Maqedonia me 13 % dhe Mali i Zi me 6 %.

Hyrjet e shtetasve, është një koncept që i referohet të gjitha hyrjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

Jo rezident konsiderohet ai person që nuk ka banuar në vëndin e vizituar për më shumë se 12 muaj radhazi përpara mbërritjes së tij në vëndin e vizituar.

A E DINI SE
Hyrjet në harkun 2010-2014 nga Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi zënë mesatarisht 62,5 % të hyrjeve të shtetasve të huaj gjithsej.

DALJET E SHTETASVE SHQIPTARË DHE HYRJET E SHTETASVE TË HUAJ NË PIKAT KUFITARE KOMBËTARE



HYRJET E JO-REZIDENTËVE NË PIKAT KUFITARE KOMBËTARE, SIPAS KOMBËSISË


	2010	2011	2012	2013	2014
Gjithsej	**2.417.337**	**2.932.132**	**3.513.666**	**3.255.988**	**3.672.591**
I . Afrika	3.193	432	1.057	919	859
II. Amerika	61.878	70.291	73.810	73.291	90.084
III. Azia Lindore dhe Paqësori	11.361	17.418	19.689	23.628	30.874
IV. Lindja e Mesme	1.247	1.178	1.524	3.944	2.607
V. Azia e Jugut	764	909	1.135	961	1.274
VI. Evropa	2.238.958	2.738.846	3.214.111	2.963.583	3.423.665
- Evropa Qëndrore / Lindore	63.722	82.418	90.643	112.333	163.006
- Evropa Veriore	85.463	109.924	117.434	119.016	137.308
- Evropa Jugore	1.912.383	2.320.746	2.759.374	2.467.195	2.821.920
- Evropa Perëndimore	141.187	186.531	200.462	210.845	237.760
- Evropa Lindore / Mesdheut	36.203	39.227	46.198	54.194	63.671
VII. Rajone të paspecifikuara	99.936	103.058	202.340	189.662	123.228

LLOGARITË KOMBËTARE

	Njësia	2010	2011	2012*	2013**
PBB (me çmime korrente)	Mln lekë	**1.239.645**	**1.300.624**	**1.335.488**	**1.364.782**
Burimet (me çmime konstante)	Mln lekë				
PBB	-	1.186.341	1.271.199	1.321.741	1.354.087
Importet e mallrave e shërbimeve (fob)	-	618.914	697.628	689.517	727.479
Përdorimet (me çmime konstante)	-				
Eksportet e mallrave e shërbimeve (fob)	-	395.386	431.921	439.565	479.581
Konsumi Final i Popullatës	-	933.884	979.035	1.019.147	1.053.310
Konsumi Final i Administratës Publike dhe i Institucioneve Jo-fitimprurëse	-	134.108	141.296	145.634	151.608
Formimi Bruto i Kapitalit Fiks	-	342.480	373.357	338.930	349.021
Ndryshimet e gjendjeve dhe Mospërputhje statistikore	-	- 603	43.217	67.983	48.047
Rritja vjetore e PBB (krahasuar me çmimet e vitit të mëparshëm)	%	**3,7**	**2,5**	**1,6**	**1,4**
	1.000 lekë	426	448	460	471
Produkti i Brendshëm Bruto për frymë	Euro	3.089	3.191	3.312	3.358
	USD	4.089	4.437	4.257	4.458

2012*Të dhëna gjysëm finale
2013** Të dhëna paraprake

PRODUKTI I BRENDSHEM BRUTO



Llogaritë kombëtare pasqyrojnë zhvillimet makro-ekonomike të një vendi. Ato tregojnë se sa është kapaciteti prodhues i vendit, sa konsumohet, investohet dhe shkëmbehet me vendet e tjera të botës. Treguesi i rritjes reale të PBB është ndër treguesit më të rëndësishëm të llogarive kombëtare.

Gjatë vitit 2013 ekonomia shqiptare shënoi një rritje reale prej +1.4 % krahasuar me vitin 2012. Konsumi final përbën peshën kryesore të shpenzimeve në ekonomi, me 89.34 % dhe u rrit me +1.94 % në terma reale. Formimi bruto i kapitalit fiks u rrit me +1.16 % në terma reale krahasuar me vitin 2012. Eksporti dhe importi i mallrave dhe shërbimeve janë rritur në terma reale me përkatësisht +7.89 % dhe +4.99 % krahasuar me vitin 2012. PBB për frymë në vitin 2013 arriti në 471 mijë lekë.

PRODUKTI I BRENDSHEM BRUTO

PBB përfaqëson vlerën totale në para të të gjithë të mirave dhe shërbimeve të prodhuara gjatë një periudhe specifike nga njësitë prodhuese rezidente brenda territorit ekonomik të një vendi. Metodat e përdorura në Shqipëri për llogaritjen e PBB janë metoda e prodhimit dhe e shpenzimeve.

A E DINI SE

PBB për frymë e Shqipërisë e shprehur ne Standartin e Fuqisë Blerëse është sa pothuajse sa një e treta e mesatare së PBB për frymë të vendeve të BE (BE=100).

Përbërësit e ofertës së parasë kanë shënuar një rritje të moderuar gjatë 4 viteve të fundit. Dallim bën viti 2014 në fund të të cilit agregati M1 shënoi një rritje vjetore prej 19 %, për shkak të rritjes së depozitave pa afat në lekë. Depozitat e përfshira në paranë e gjerë u rritën me 3 %. Depozitat e sektorëve të tjerë rezidentë[1], të cilat përfaqësojnë rreth 86 % të vlerës së përgjithshme të depozitave, u rritën me 1 % në krahasim me një vit më parë. Depozitat e korporatave jofinanciare u rritën me rreth 20 %, duke shënuar një rritje të ndjeshme në krahasim me vitet e mëparshme.

Kredia për ekonominë u rrit me 2 % gjatë vitit 2014 duke shënuar një përmirësim të lehtë në krahasim me një vit më parë. Sektori që ka dhënë kontributin më të madh në rritjen e kredisë ishte ai i korporatave jofinanciare private. Kredia për këtë sektor u rrit me 2 % gjatë këtij viti dhe përfaqësonte rreth 70 % të kredisë për ekonominë. Kredia për sektorët e tjerë rezidentë shfaqi shenja të lehta përmirësimi në krahasim me vitet e mëparshme, gjatë të cilëve nuk ka shënuar ndryshime.

[1]Sektorët e tjerë rezidentë përfshijnë individët dhe institucionet-jo-për-qëllime-fitimi.

A E DINI SE


Depozitat e sektorëve të tjerë rezidentë[1], të cilat përfaqësojnë rreth 86 % të vlerës së përgjithshme të depozitave, u rritën me 1 % në krahasim me një vit më parë

OFERTA E PARASË DHE DEPOZITAT SIPAS SEKTORËVE (MLN LEKË)

	2010	2011	2012	2013	2014
Baza monetare	283.454	289.81	297.722	308.074	332.899
Paraja jashtë korporatave depozituese	195.059	194.923	192.705	198.893	217.666
Agregati M1	275.427	276.898	281.247	295.877	353.322
Agregati M2	604.517	647.003	669.577	693.172	722.357
Agregati M3	980.284	1.070.150	1.123.408	1.148.981	1.195.086
Depozitat e përfshira në paranë e gjerë	785.225	875.226	930.703	950.088	977.421
Qeveria lokale dhe administrata publike	1.496	1.547	1.124	1.735	2.287
Korporata publike jofinanciare	18.76	15.155	12.895	11.852	18.067
Korporata të tjera financiare	8.895	7.978	10.317	10.167	8.523
Korporata të tjera jofinanciare	88.205	86.392	82.538	88.150	105.805
Sektorë të tjerë rezidentë	667.869	764.154	823.829	838.185	842.74

Burimi: Banka e Shqipërisë

KREDIA PËR EKONOMINË SIPAS SEKTORËVE



KURSI I KËMBIMIT TË LEKUT NDAJ VALUTAVE KRYESORE (MESATARE E PERIUDHËS)

	2010	2011	2012	2013	2014
Lekë / USD	103,94	100,90	108,18	105,67	105,48
Lekë / EURO	137,79	140,33	139,04	140,26	139,97
Lekë / JPY	118,66	126,68	135,74	108,50	99,78
Lekë / CHF	99,87	113,98	115,39	114,00	115,26

Burimi: Banka e Shqipërisë

LLOGARIA KORRENTE (MILIONË EURO)

	2010	2011	2012	2013	2013*	2014*
Llogaria korrente	-1.019	-1.225	-978	-1.035	-1.035	-1.303
Mallra	-2.083	-2.242	-1.999	-1.72	-1.893	-2.137
Eksport	1.172	1.406	1.526	1.756	1.063	925
Import	-3.254	-3.647	-3.525	-3.476	-2.956	-3.062
Shërbime	232	135	213	-16	155	268
Eksport	1.751	1.747	1.673	1.656	1.829	2.031
Udhëtime	1.227	1.169	1.145	1.107	1.107	1.283
Import	-1.519	-1.612	-1.46	-1.673	-1.674	-1.763
Udhëtime	-1.032	-1.122	-1.003	-1.113	-1.113	-1.196
Të ardhurat	-90	-25	-72	21	21	-160
Të ardhura hyrëse	286	216	188	138	138	111
Të ardhura dalëse	-376	-241	-260	-117	-117	-270
Transfertat korente	922	906	880	680	680	725
Transferta korente hyrëse	1.077	1.012	1.026	810	810	852
Dërgesa nga emigrantët	697	670	680	547	547	595
Transferta korente dalëse	-154	-105	-147	-130	-130	-127

Burimi: Banka e Shqipërisë

*Për vitet 2013-2014 bilanci i pagesave është hartuar sipas Manualit të Gjashtë të Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare (FMN, 2009)

Normat kryesore të interesit përfshirë yield-in e bonove të thesarit 12 mujore, kanë ardhur në rënie gjatë gjithë periudhës 2010-1014 duke reflektuar kryesisht uljen e vazhduar të normës bazë të interesit[2] që prej fillimit të vitit 2012. Normat mesatare të kredive dhe depozitave të reja 12-mujore në lekë për vitin 2014 shënuan përkatësisht 7,7 % dhe 1,9 %, ndërkohë që yield-i i bonove të thesarit 12 mujore për të njëjtën periudhë ishte 3,4 %. Gjatë periudhës 2010-2014, leku ka arritur vlerën më të ulët ndaj USD në vitin 2012 dhe ndaj Euros në vitin 2011. Në fund të vitit 2014 kursi i këmbimit të lekut kundrejt dy valutave kryesore ishte 140,14 ALL/Eur dhe 115,23 ALL/USD.

Në vitet 2012-2013 defiçiti korrent shënoi rreth 10 % të PBB-së ndërkohë që në vitin 2014, rritja vjetore e defiçitit ishte rreth 26 %. Defiçiti korrent shkaktohet nga defiçiti në tregtinë e mallrave, i cili në vitin 2014 ishte rreth 2,1 miliardë Euro. Në kategorinë e shërbimeve, shërbimet kryesore janë ato të udhëtimit. Në vitin 2014 të ardhurat nga eksporti i udhëtimeve ishin rreth 2 miliardë Euro, ndërsa shpenzimet rreth 1,2 miliardë Euro. Llogaria e transfertave korrente vijon të regjistrojë sufiçit, të nxitur kryesisht nga dërgesat nga emigrantët të cilat në vitin 2014 shënuan rreth 600 milionë Euro.

[2]Norma e marrëveshjeve të riblerjes njëjavore.

A E DINI SE

Normat mesatare të kredive dhe depozitave të reja 12-mujore në lekë për vitin 2014 shënuan përkatësisht 7.7 % dhe 1.9 %

32 Banka


Borxhi i jashtëm bruto i Shqipërisë në fund të vitit 2014 arriti në 6,6 miliardë Euro. Pjesa më e madhe e borxhit të jashtëm zotërohet nga sektori i qeverisë së përgjithshme, i ndjekur nga sektori bankar. Rreth 80 % e borxhit të jashtëm përbëhet nga borxhi afatgjatë. Rritja e detyrimeve ndaj rezidentëve me ritme më të shpejta sesa rritja e pretendimeve të tyre ndaj pjesës tjetër të botës, ka rezultuar në një pozicion neto investimesh prej -3,3 miliardë eurosh në fund të vitit 2013. Detyrimet më të mëdha të rezidentëve ndaj jorezidentëve janë në formën e investimeve direkte dhe të investimeve të tjera, ndër të cilat dallojnë huatë dhe monedhat dhe depozitat. Mjetet e rezervës në fund të vitit 2014 ishin 2,2 miliardë euro, ose të mjaftueshme për mbulimin e 5,5 muajve importe mallrash dhe shërbimesh.

BORXHI I JASHTËM BRUTO DHE POZICIONI I INVESTIMEVE NDËRKOMBËTARE (MILIONË EURO)

	2010	2011	2012	2013	2014
Borxhi i jashtëm bruto	4.1	4.958	5.513	6.177	6.665
1. Qeveria e përgjithshme	1.886	2.069	2.224	2.29	2.648
2. Autoriteti monetar	106	99	90	79	77
3. Bankat	604	871	1.089	1.075	1.219
4. Sektorë të tjerë	793	1.038	1.099	1.085	1.156
5. Investimi direkt: Huatë ndërkompani	711	881	1.012	1.649	1.567
Borxhi i jashtëm afatshkurtër	557	845	1.115	1.267	1.322
Borxhi i jashtëm afatgjatë	3.543	4.113	4.399	4.91	5.344
Pozicioni neto i investimeve	-2.98	-4.24	-4.031	-3.366	
a. Investime direkte	-2.321	-3.267	-3.114	-2.68	
b. Investime portofoli	-260	-341	-261	-161	
c. Derivativë financiarë	-	-	-2	-	
d. Investime të tjera	-2.303	-2.545	-2.626	-2.54	
e. Mjetet e rezervës	1.905	1.913	1.973	2.015	2.192

Burimi: Banka e Shqipërisë

BORXHI I JASHTËM BRUTO



A E DINI SE

Mjetet e rezervës në fund të vitit 2014 ishin 2,2 miliardë euro, ose të mjaftueshme për mbulimin e 5,5 muajve importe mallrash dhe shërbimesh.


NDËRMARRJET AKTIVE SIPAS AKTIVITETIT EKONOMIK

Aktiviteti ekonomik	2010	2011	2012	2013	2014
Gjithsej	**103.038**	**109.039**	**106.837**	**111.083**	**112.537**
Bujqësia, pyjet, peshkimi	1.700	1.932	1.775	1.690	2.260
Industria	9.898	10.354	9.886	10.333	10.154
Ndërtimi	4.451	4.813	4.752	4.819	4.575
Tregtia	43.325	45.214	43.851	44.878	44.969
Transporti dhe magazinimi	8.307	8.505	7.961	8.024	7.562
Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	15.674	17.113	16.888	17.825	18.061
Informacioni dhe komunikacioni	2.009	2.270	2.330	2.495	2.590
Shërbime të tjera	17.674	18.838	19.394	21.019	22.366

NDËRMARRJET AKTIVE TË HUAJA E TË PËRBASHKËTA (SHQIPTARË + TË HUAJ), 2014

Shtetet	Gjithsej	
	numër	%
Gjithsej	**5.245**	**100**
Italia	2.267	43
Greqia	640	12
Turqia	415	8
Kosova	253	5
Të tjera	1.670	32

NDËRMARRJET E REJA, 2014



Ndërmarrjet e reja për vitin 2014 numërohen 17.377 ndërmarrje aktive. 34,4 % e ndërmarrjeve të reja ushtrojnë aktivitetin ekonomik "Tregti", ndërsa 2,2 % e tyre ushtrojnë aktivitetin ekonomik "Ndërtim". Numri i ndërmarrjeve aktive në fund të vitit 2014 është 112.537 ndërmarrje.

Ndërmarrjet e huaja e të përbashkëta zënë rreth 4,7 % të ndërmarrjeve gjithsej për vitin 2014. Pronarët apo bashkëpronarët e huaj më së shumti janë italianë, me 43,2 %. Edhe gjatë viteve të mëparshme, pronarët dhe bashkëpronarët nga Italia kanë qenë mbizotërues.

REGJISTRI STATISTIKOR I NDËRMARRJEVE
Përmban të gjitha njësitë ligjore jo bujqësore (ndërmarrjet e institucionet) që ushtrojnë aktivitet ekonomik brenda territorit të Shqipërisë.

A E DINI SE
Shkalla e lindshmërisë së ndërmarrjeve të reja për vitin 2014 është 15 %. 5,385 ndërmarrje të reja kanë pronare/administratore femër.

Tirazhi 500 kopje